



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NTP Lanti Plast" të datës 13.09.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH - RITENDER" me nr. të prokurimit 616-24-8898-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTP Lanti Plast" të datës 13.09.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH - RITENDER" me nr. të prokurimit 616-24-8898-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "NTP Lanti Plast (tutje "parashtruesi") me datë 13.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH - RITENDER" me nr. të prokurimit 616-24-8898-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** "KËRKESAT NGA 1.5 MILION I KENI BËRË 2 MILION PËRMES ADMINISTRATES DHE NGA 1.2 MILION NË 1.6 MILION KONTRATA KU ËSHTË KËRKUAR EDHE 60% PËR LIDERIN. Që I bie se AK ka bërë koncentrimin e tenderit për një OE të cakuar duke na diskriminuar në masë dhe mos lejuar pjesëmarrjen. Sipas LPP-së me ri-shpalljen e Aktivitetit të Prokurimit kriteret duhet të jenë qdoherë të njejta dhe asesi të ndryshme, Andaj bazuar në këto që thamë më lartë kërkojmë aprovimin e kërkesës tonë largimin dhe përmisimin e kriterëve të vendosura në ri-tenderim"

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit,** fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Lidhur pretendimet ankimore, parashtruesi ka kontestuar pothuajse të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Njëkohësisht ka pretenduar që kërkesat në këtë dosje të tenderit ndryshojnë nga një dosje tjetër e tenderit lidhur me një aktivitet të prokurimit që është anuluar. Fillimisht duhet sqaruar se të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke përfshirë edhe kërkesat për qarkullim financiar dhe kërkesat për referenca për punët e ngjashme të realizuara në të kaluarën, janë hartuar dhe formuluar në përputhje të plotë me LPP, RRPP si dhe UPP. Pra kërkesat duke përfshirë edhe lartësitë e kërkuara të qarkullimit apo referencave janë brenda marzheve të lejuara me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe ky fakt si i tillë nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Ndërsa sa i përket krahasimeve që i ka bërë parashtruesi të kësaj dosje të tenderit me dosje të tjera të tenderit, duhet potencuar se ky aktivitet i prokurimit është i ndarë de jure dhe de facto nga aktivitetet tjera dhe si i tillë zhvillohet në mënyrë të pavarur sipas LPP në fuqi.

Sidoqoftë, të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit janë formuluar në mënyrë të saktë dhe janë absolutisht të domosdoshme për të realizuar në mënyrë efikase dhe efektive kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Për më tepër të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit janë në përputhje të plotë me natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe as ky fakt nuk kontestohet nga parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 16.09.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.